



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 4
29.12.2014

NR. VENDIMI 14
09.06.2015

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e përbërë nga:

KODIAN KURUSHI	GJYQTAR
IRENA GJOKA	GJYQTARE
FRAN PRENDI	GJYQTAR

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Ermira Terbuni**, në Tiranë, në seancë gjyqësore, sot më 09. 06. 2015 mori në shqyrtim, kërkesën që ju përket palëve:

KËRKUES: Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, Përfaqësuar nga **Prokurori Ened Nakuçi**.

KUNDER: **K.(L.) B.**, i biri xxx dhe i xxx, lindur xxx, dhe banues ne lagjen xxx përfaqësuar nga avokati **J. V.**, anëtar i dhomës së avokatisë anëtar i dhomës së avokatisë xxx me nr. xxx license dhe nipt xxx i zgjedhur me prokurë të posaçme me nr. xxx rep./xxx kol. datë xxx nga i padituri.

OBJEKTI: Konfiskim pasurie që është një pronë e paluajtshme e llojit xxx me sipërfaqe xxx m2 me numër pasurie nr.xxx, Zk.xxx, Vol.xxx, fq.xxx xxx me sip.xxx m2 me referencë xxx, xxx, ndodhur në xxx në emër të K.M.B. blerë në datë xxx

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 datë 03. 12. 2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimet të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës *përfaqësuesi i prokurorisë kërkoi:*

Konfiskimin e xxx me sipërfaqe xxx m² që ndodhet në xxx” në pronësi të të paditurit K.(L.) B.

Përfaqësuesit i palës së paditur: Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga prokuroria.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të prokurorit, provat e paraqitura nga palët në gjykim dhe si degjoi kërkesen e tyre përfundimtare

V Ë R E N

Kërkesa për konfiskimin e xxx me sipërfaqe xxx m² që ndodhet në xxx” në pronësi të të paditurit K.(L.) B. duhet të pranohet pasi ajo është e mbështetur në prova dhe në ligji.

Gjendja e akteve të sjella në gjykim nga prokuroria

Prokuroria për Krimet e Rënda xxx më datë xxx ka paraqitur në gjykatë kërkesën për konfiskimin e xxx me sipërfaqe xxx m² që ndodhet në xxx në pronësi të të paditurit K. (L.) B.

Kërkesa për konfiskimin xxx në pronësi të të paditurit është sjellë në gjykatë si rrjedhojë e një vendimi të mëparshëm të dhënë nga gjykata me nr. xxx datë xxx për sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme si rezultat i kërkesës së paraqitur nga prokuroria.

Në shqyrtimin e kërkesës për sekuestrimin e pasurive ndaj të paditurit “Me shkresën Nr.xxx datë xxx Drejtorja e Policisë xxx ka dërguar materialet duke referuar fillimin e procedimit pasuror ndaj shtetasit K.(L.) B., pasi më datë xxx është arrestuar nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore xxx për veprën penale të “*Posedimit të lëndëve narkotike*” pasi së bashku me një shtetas xxx janë kapur në flagrancë me xxx gram heroinë si dhe xxx Euro. Gjithashtu nga hetimi ka rezultuar se më datën xxx

është realizuar ndryshimi i emrit në zyrën e gjendjes civile xxx nga L. në K.

Gjatë hetimit nga Drejtoria e Policisë së Qarkut xxx në bashkëpunim me DPPP për këtë shtetas dhe familjarë të tij rezulton të kenë kryer transaksione të dyshimta në vlera të konsiderueshme monetare.

Në lidhje me këtë fakt, Prokuroria e rrethit gjyqësorë xxx ka rregjistruar procedimin penal nr. xxx date xxx për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Për këtë shtetas janë kryer verifikime dhe veprime hetimore;

Me shkresat nr. xxx date xxx, dhe nr. xxx date xxx, është kërkuar dosja hetimore nga prokuroria xxx e cila me shkresën Nr.xxx datë xxx, ka vënë në dispozicion pjesërisht dosjen hetimore nr. xxx viti xxx dhe me shkresën nr. xxx date xxx, ka vënë në dispozicion dosjen nr. xxx të vitit xx duke sqaruar se procedimi penal është rifilluar pas administrimit të akteve të letërporosisë nga autoritetet gjyqësore xxx dhe po kryhen hetime.

Në kushtet kur ky shtetas (i padituri) hetohet në shtetin xxx për veprën penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve" në bashkëpunim me një shtetas xxx, vepër kjo që parashikohet dhe nga Kodi Penal në nenin 283/2 të tij, në bazë të nenit 3 pika « ç » shtetasi K. (L.) B. dhe familjarët e tij janë subjekte të hetimit pasuror sipas ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 "Per parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". Për këtë shtetas familjarët e tij janë kryer verifikimet pasurore.

Nga hetimi rezulton se i hetuari K.(L.) B. dhe familjarët e tij, nuk dispononin të ardhura të ligjshme që të justifikojnë vlerat monetare dhe pasurinë e paluajtshme, por këto pasuri dyshohet se janë krijuar si rezultat i aktivitetit të paligjshëm në fushën shitjes së lëndëve narkotike.

Me vendimin nr. xxx datë xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda është vendosur sekuestrimi i të gjitha pasurive si më poshtë vijon:

Sekuestrimin e shumave në depoziten e kursimit me gjendje xxx (xxx) EURO, e cila maturohet ne date xxx, e

cila lidhet me llogarine me nr. xxx që i përkasin shtetases A.L.S. e dtl. xxx.

Sekuestrimin e shumave në depozitën e kursimit me gjendje aktuale xxx (xxx) USD, e cila lidhet me llogarinë me nr. xxx e cila i përket klientes A.L.S. e dtl.xxx.

Kjo sekuestro është zgjatur për një periudhë tre mujore me vendimin nr. xxx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda.

Gjatë hetimit dhe pas sekuestrimit të shumave monetare të mësipërme për shtetasin K.(L.)B. është urdhëruar kryerja e këqyrjes së rregjistrimit të noteres V.D. në qytetin e xxx për kontratën me numer Rep/kol xxx/xxx për shitblerjen e pasurisë.

Me procesverbalin e këqyrjes datë xxx rezulton se në këtë zyre noteriale është këqyrrur kontrata me numër rep/kol xxx datë xxx për shitblerjen e pasurisë nr. xxx në ZK nr. xxx xxx me sipërfaqe xxx m² në vlerën xxx lekë me palë shitëse P.M.V. dhe palë blerëse shtetasi K.M.B. Bashkë me kontratën ndodhet dhe praktika e shitblerjes.

Gjithashtu nga ana e policisë gjyqësore me procesverbalin e datës xxx të këqyrjes dhe marrjes së akteve pranë Zyrës Rajonale të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme xxx, është administruar praktika e regjistrimit të pasurisë së mësipërme e cila rezulton të jetë regjistruar në emër të shtetasit K.M.B. si më poshtë vijon:

Pasuria nr. xxx, Zk.xxx, Vol.xxx, fq. xxx xxx me sip. xxx m² me reference xxx, xxx si dhe dosja e origjinës së pronës gjithsej 34 fletë.

Pasuria e mësipërme rezulton se është fituar nga personi i dyshuar K.M.B. pas përfshirjes së këtij të fundit në veprimtarinë kriminale. Gjithashtu nga hetimi provohet se ky i fundit dhe familjarët e tij nuk kanë të ardhura të cilat mund të justifikojnë një pasuri të tillë.

Në këto kushte kjo pasuri plotëson kriteret e parashikuara nga neni 11 i ligjit nr. 10192 date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, ndaj si e tille kjo pasuri është sekuestruar me vendimin nr. xxx datë xxx.

Vendimi i gjykatës është vënë në ekzekutim nga përmbartimi dhe pasuritë janë marrë në administrim nga administratorët e agjensisë së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Më pas pala e paditur pasi është vënë në dijeni të vendimit të gjykatës i është drejtuar prokurorisë duke i paraqitur prova shkresore të cilat sipas vlerësimit që i ka bërë prokurori kanë përlligjur marrjen e një vendimi nga prokuroria për pasuritë e sekuestruara me vendim gjykate.

Dy llogaritë bankare në emër të shtetases A.S. që është tezja e të paditurit nga hetimi pasuror rezultoi se nuk ekzistonin kushtet për të vazhduar më tej me kërkesën e prokurorisë për konfiskimin e tyre, pasi nuk plotësoheshin kushtet e parashikuara nga neni 24 i ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë.” (shih vendimin e pushimit te pjeshëm të hetimit pasuror ndaj shtetases A.S.). Për këtë shkak prokuroria ka pushuar pjesërisht hetimin pasuror ndaj pasurive të sekuestruara të shtetases A.S.

Si rrjedhim prokuroria ka sjellë kërkesën për konfiskim vetëm të pasurisë së paluajtshme tokë arë që është në pronësi të të paditurit.

Shqyrtimi gjyqësor

Në gjykimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë së paluajtshme tokë arë përfaqësuesi i palës së paditur paraqiti në gjykatë disa argumente me të cilat ai kërkoi që gjykata të rrëzoi kërkesën e prokurorisë. Argumentet e palës së paditur të paraqitura në gjykatë përfshijnë këto pika:

- Toka e blerë nga i padituri është pasuri që ka një prejardhje të ligjshme pasi i padituri e përlligj blerjen me këto burime të ardhurash:
 - Të ardhura nga kontrata e qerasë datë xxx për dhënien me qera të një pasurie të paluajtshme te pallatet xxx në xxx me sipërfaqe xxx m² në shumën xxx lekë në muaj (i revokuar prej palëve më datë xxx. Afati fillon nga data xxx).

- Të ardhura nga kontrata e qerasë datë xxx për dhënien me qera të një pasurie të paluajtshme te pallatet xxx në xxx me sipërfaqe xxx m² në shumën xxx lekë në muaj (me afat 5 vjecar që fillon më datë xxx deri në datë xxx).
- Të ardhura nga kontrata e qerasë datë xxx për dhënien me qera të një pasurie të paluajtshme në lagjen “xxx” xxx me sipërfaqe xxx m² (me afat 2 vjecar duke filluar ky afat më datë xxx) me shumën xxx lekë.
- Shkresë e Bankës xxx nr. xxx prot. datë xxx, nga e cila rezulton se shtetasja A.H. (vjehera) e të paditurit ka përfituar shpërblim nga Vendimi i Këshillit të Ministrave si bashkëshortja burrit të saj të vdekur i cili ka qenë i persekutuar. Shpërblimin vjehera e të paditurit e ka marrë në dy këste më datë xxx në shumën xxx lekë dhe në datë xxx më datë xxx lekë.

– Prona nga i padituri është blerë në datë xxx dhe çmimin për tokën i padituri e ka paguar me këste deri në vitin xxx. Ky send nuk mund të jetë objekt konfiskimi pasi kalimi i pronësisë së tij është bërë para datës xxx datë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë.”

– Prokuroria e rrethit gjyqësor xxx e ka pushuar çështjen penale ndaj të paditurit për veprën penale të “Pastrimit të produkteve që rrjedh nga vepra penale” për shkak se fakti nuk ekziston bazuar në nenin 324/1 i Kodit të Procedurës Penale.

Vlerësimi i gjykatës.

Argumenti për ligjshmërinë e pronës së të paditurit

Për argumentin e prejardhjes së ligjshme të pasurisë tokë arë të blerë nga i padituri gjykata çmon se i padituri K.(L.) B. me kontratën e shitblerjes me nr. xxx rep/nr. xxx kol. datë xxx ka blerë nga shtetasi P.M.V. një xxx xxx me sipërfaqe xxx m² që ndodhet në zonën “xxx” në xxx në shumën **xxx lekë**.

Në gjykim i padituri nuk ka paraqitur asnjë burim të ardhursh për veten e tij sesi ai jeton dhe sesi ai i siguron të ardhurat e jetës së tij. Në gjykim i padituri është mjaftuar të deklaroj se ai ka jetuar në shtetin xxx që nga viti xxx duke punuar në emigracion kryesisht në “punë të zezë” pa specifikuar se çfarë punësh ka kryer ai konkretisht. I padituri është martuar me shtetasen P. B. me të cilën ai ka edhe x fëmijë të mitur M. dhe A. B. Në gjykim i padituri nuk provoi nëse bashkëshortja e tij ka qenë apo është në marrëdhënie pune.

Të vetmet burime të ardhurash për të paditurin të konfirmuara në gjykim janë paratë që babai i tij shtetasi M.B. fiton nëpërmjet qerave për dy ambienteve që ai u ka dhënë personave qeramarrës për aktivitet tregtar që ndodhen njëri në qytetin e xxx dhe tjetri në qytetin e xxx, si dhe të ardhurat që ka përfituar bashkëshortja e të paditurit si shpërblim që i takonte të atit të saj të vdekur për shkak se i ndjeri ishte i persekutuar nga regjimi i kaluar.

Referuar kontratës së shitblerjes së xxx xxx rezulton se i padituri e ka shlyer detyrimin për pagimin e çmimit të vlerës së tokës në kohën e lidhjes së kontratës pra në datë xxx. Rrjedhimisht deri në datë xxx gjykata do të vlerësojë të ardhurat e përfituara nga të afërmit e të paditurit.

Për sipërfaqen e objektit prej xxx m² që ndodhet në xxx babai i të paditurit ka fituar të ardhura nga qeraja shumë në xxx lekë. Këtë ambient babi i të paditurit e ka dhënë me qera ndaj dy subjekteve të ndryshëm në shumat xxx lekë dhe xxx lekë.

Për sipërfaqen e objektit prej xxx m² që ndodhet në xxx babai i të paditurit ka fituar të ardhura nga qeraja në shumën xxx lekë.

Bashkëshortja e të paditurit është një nga tre trashëgimtarët ligjor të të ndjerit A.H. bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore të dhënë nga Gjykata e shkallës së parë xxx me vendimin nr. xxx datë xxx. Deri në këtë datë bashkëshortja e të paditurit ka përfituar vetëm një të tretën e këstit të parë të shpërblimit të shpërndarë nga Banka xxx dhe më konkretisht bashkëshortja e të paditurit ka përfituar shumën xxx lekë.

Në total nga të ardhurat e përfituara prej të atit dhe bashkëshortes së tij i padituri K. (L.) B. deri në datë xxx ka përfituar shumën prej **xxx lekë**. Kjo shumë është me e vogël se shuma që ka paguar i padituri për tokën arë që është blerë prej tij. Vlen të theksojmë që nga kjo shumë nuk

janë zbritur shpenzimet e nevojshme që i duhen pjesëtarëve të një familje për jetesë si dhe shpenzimet e tjera që janë kryer prej të paditurit ose familjarëve të tij gjatë kësaj periudhe.

Bazuar në certifikatën e përbërjes familjare të të paditurit rezulton se familja e tij përbehet nga gjashtë pjesëtarë që janë i ati, e ëma, i padituri, bashkëshortja dhe dy fëmijët e tij.

Asnjë prej pjesëtarëve të familjes së të paditurit nuk ishte në marrëdhënie pune si dhe nuk kishte përfituar ndonjë pasuri përveç atyre të përmendur më lart.

Rrjedhimisht të ardhurat e siguruara prej të paditurit (pa përfshirë edhe shpenzimet e familjarëve të tij) nuk përlligjin në mënyrë të dukshme prejardhjen e ligjshme të pasurisë së fituar nga i padituri që është xxx xxx në pronësi të tij me sipërfaqe xxx m². Pra i padituri nuk e justifikon prejardhjen e ligjshme të pronës objekt konfiskimi me të ardhurat e deklaruara prej tij në gjykatë.

Argumenti për mos prapaveprueshmërinë në kohë të ligjit “*Antimafia*”.

I padituri argumentoi se ai e ka blerë xxx xxx në vitin xxx duke paraqitur një deklaratë noteriale me deklaratimet e tij dhe të shitësit P.M.V. hartuar para noterit më datë xxx. Në këtë deklaratë deklaruesit pranojnë se ata kanë lidhur një marrëveshje për shitjen e objektit që në vitin xxx kohë në të cilën ka filluar edhe pagesa me këste. Në vitin xxx u nënshkrua formalisht kjo kontratë.

Sipas të paditurit meqenëse kontrata është lidhur që në vitin xxx ky ligj nuk mund të zbatohet për konfiskimin e pronës sepse ligji vetë ka hyrë në fuqi në vitin 2009 pasi i padituri është bërë pronar i sendit të sekuestruar.

Deklarimi i palëve kontraktuese i vitit xxx nuk ka asnjë vlerë juridike. Kontratat për shitblerjen e pasurive të paluajtshme janë kontrata me natyrë konsensuale të cilat sjellin efektet ligjore për palët kontraktuese vetëm kur ato nënshkruhen nga vetë palët. Rrjedhimisht kontrata e shitjes së xxx xxx ka efekt për palët që prej datës xxx kur kjo kontratë është nënshkruar prej tyre. Pra kontrata ka sjellë efekte për palët pas hyrjes në fuqi të ligjit “*antimafia*”.

Pavarësisht argumentit të mësipërm ligji nr.10192 datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” ka efekte prapavepruese. Ky ligj zbatohet edhe për pasuri të fituara para hyrjes në fuqi të tij me kushtin që pasuritë të jenë fituar nga veprimtari kriminale që parashikon ligji “*antimafia*”.

Rrjedhimisht ky argument nuk është i mbështetur në ligj.

Argumenti për pushimin e çështjes penale nga prokuroria xxx për shkak se fakti nuk ekziston.

Prokuroria kishte regjistruar një procedim penal në ngarkim të të paditurit për veprën penale të *“Pastrimit të produkteve të veprës penale”* parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Ky procedim penal është regjistruar nga prokuroria xxx mbi bazën e një njoftimi me shkrim të sjellë nga autoritetet gjyqësore xxx.

Mbi bazën e materialit të sjellë nga homologët grek ka rezultuar se i padituri po hetohej në shtetin xxx për veprën penale të *posedimit dhe shitjes së lëndëve narkotike*. Sipas këtij informacioni shkresor i padituri po hetohej së bashku me një shtetas xxx dhe ky i fundit është arrestuar për shkak se atij i janë kapur në flagrancë nga struktura hetimore xxx një sasi prej xxx gram heroinë dhe xxx euro.

Me vendimin datë xxx prokuroria xxx bazuar në nenin 328/1/a të Kodit të Procedurës Penale pushoi hetimet ndaj të paditurit për veprën penale të *“Pastrimit të produkteve të veprës penale”* parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal për shkak se fakti nuk ekziston.

Gjykata vlerëson se vendimi i pushimit të hetimit nga prokuroria ndaj të paditurit nuk ka ndikuar në hetimin dhe gjykimin e pasurisë objekt gjykimi që gëzon i padituri.

Më konkretisht me vendimin nr. xxx datë xxx të gjykatës së shkallës së parë *“Për Krimet e Rënda”* xxx është sekuestruar xxx xxx në pronësi të të paditurit. Kronologjikisht vendimi i gjykatës së shkallës së parë *“Për Krimet e Rënda”* xxx për sekuestrimin e pronës është dhënë prej saj një vit më vonë se vendimi i pushimit të hetimit të marrë nga prokuroria xxx ndaj të paditurit.

Vendimi i sekuestrimit të tokës arë ndaj të paditurit është mbështetur në dyshimin se i padituri kishte marrë pjesë në kryrjen e veprës penale të *Posedimit dhe shitjes së narkotikëve* që kishte ndodhur në shtetin xxx dhe jo për veprën penale të *“Pastrimit të produkteve të veprës penale”* për të cilën i padituri ishte hetuar nga prokuroria e rrethit gjyqësor xxx.

Në kushtet kur ky shtetas hetohej në shtetin xxx për veprën penale të

“Prodhimit dhe shitjes se narkotikëve” në bashkëpunim me një shtetas xxx, veprë kjo që parashikohet dhe nga Kodi Penal shqiptar në nenin 283/2 të tij, në bazë të nenit 3 pika « ç » shtetasi K.(L.) B. dhe familjaret e tij janë subjekte të hetimit pasuror sipas ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Pra i padituri është subjekt i veprimit të ligjit “*antimafia*”.

Në përfundim gjykata vlerëson se i padituri nuk arriti të provojë në këtë gjykim se pasuria e tij që është një xxx xxx blerë prej tij më datë xxx ka prejardhje të ligjshme.

Në të kundër në procesin gjyqësor rezultoi duke u mbështetur në aktet e sjella prej autoriteteve gjyqësore greke të konfirmuara edhe nga vendimi i sekuestrimit të xxx xxx se i padituri dyshohet se ka marrë pjesë në një veprimtari kriminale që parashikohet si e tillë nga neni 283 i Kodit Penal. Si rrjedhim i padituri është subjekt i ligjit *antimafia* pasi personat që dyshohen se kanë kryer veprën penale të *Prodhimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike* janë subjekte të hetimit pasuror sipas ligjit *antimafia*.

Pasuria e fituar nga i padituri me kontratën e shitblerjes nuk i përgjigjet dukshëm nivelit të të ardhurave apo fitimeve të ligjshme të deklaruar nga i padituri dhe të konstatuara në gjykim.

Gjithashtu rezultoi se i padituri është në zotrim të plotë të xxx xxx e cila është e sekuestruar me vendim gjykate.

Ndodhur në këto kushte gjykata vlerëson se xxx xxx me sipërfaqe xxx m² në pronësi të të paditurit K. (L.) B. do të konfiskohet.

PËR KËTO ARSYE -

Gjykata bazuar në nenin 24, 25, 26, 27 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009 "*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive*"

V E N D O S I

- Pranimin e kërkesës.
- Konfiskimin e pronës së paluajtshme të llojit xxx xxx me **sipërfaqe xxx m²** me numër pasurie nr. xxx, Zk. xxx, Vol.xxx, fq.xxx xxx me referencë xxx, xxx, e ndodhur në xxx zonën xxx në emër të të paditurit K.M.B. blerë prej tij në datë xxx.
- Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluatshme të ngarkohet z. S.M., i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave xxx.
- Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit xxx.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të paditurit.
- Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit xxx brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së tij.
U shpall në Tiranë më datë 09. 06. 2015.

Sekretare

Gjyqtar

Ermira Tërbuni

Klodian Kurushi

